




REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA POLICAN

RELACION TEKNIK

*“Rikonstruksion i rrugëve, shesheve dhe godinave
publike ne Bashkinë Polican”*



MIRATOI

KRYETARI I BASHKISË

ADRIATIK ZOTKAJ



Qëllimi i Studimit

Qëllimi i kësaj procedure blerje materiale është të kryejë Projektin "Rikonstruksion i rrugëve, shesheve dhe godinave publike ne Bashkinë Polican, perkatesisht: Rruga "Rilindja", "Parkingu pas Bashkisë", Rruga "Para pallateve Poligon", "Godina e pensionisteve" dhe "Banjo publike".

Ky Raport paraqet rezultatet e aktiviteteve të zbatuara në fazën e dyte, të quajtur Projekt Zbatimi.

Policani është një qytet i vogël në pjesën qendër-jugore të Shqipërisë, bën pjesë në Qarkun e Beratit. I populluar prej afro 10.000 banorësh, qyteti është i rrethuar nga disa kodra, nga të cilat mendohet të ketë prejardhjen edhe emri i tij (poli - shumë (nga greqishtja) dhe çan - kodër (në gjuhën kineze, duke pasur parasysh kontributin kinez të dhënë për ndërtimin e kombinatit, që më vonë do ti jepte jetë edhe vet qytetit)).



Qyteti është ndërtuar në vitet '60 (1960) nga qeveria

komuniste, qëllimi i së cilës ishte të krijonte një qytet industrial për prodhimin e armëve dhe municioneve. Qyteti është ndërtuar në vitet '60 (1960) nga qeveria komuniste, qëllimi i së cilës ishte të krijonte një qytet industrial për prodhimin e armëve dhe


municioneve. Lindja e qytetit të Policanit ka mbetur e fiksuar në kujtesën e banorëve vendas, si qyteti që zbuti pasojat e krizës ekonomike të zonës dhe ushtroj ndikim të ndjeshëm në përmirësimin e gjendjes materiale dhe rritjen e nivelit të jetesës së saj. Policani ka qene një fshat i vogël për t'u transformuar më vonë në një qytet industrial. Në vitin 1961-1966 u kthye në një kantier ndërtimi, me objektiv ngritjen e Uzinës Mekanike për prodhime ushtarake, që më vonë do të formonte Kombinatin Mekanik Ushtarak, i cili ndodhet në pjesën jugore të qytetit. Me fillimin e prodhimeve ushtarake, thithjen e një fuqie punëtorë të konsiderueshme nga disa rrethe të vendit, në vitin 1966-1967 u konsolidua qyteti i

Poliçanit me një bazë të fuqishme të industrisë mekanike dhe asaj ushtarake.

Qyteti ndodhet në lartësinë 519 m m.n.d por prania e lumit Osum i jep qytetit një klimë të tipit mesdhetar, me të katra stinët.

Natyra e Poliçanit është e larmishme dhe komplekse, ajo përbëhet nga fushat, luginat, kodrat e deri tek majat më të larta e të thepisura të mbuluara nga dëbora në 5-6 muaj të vitit. Relievi i Poliçanit shtrihet nga lartësitë rreth 200 m mbi nivelin e detit në luginën e Osumit deri në 2417 m në majën "Çuka Partizane", në malin e Tomorit. Format kryesore të relievit janë: luginat, kodrat dhe vargjet malore të cilat formojnë një mozaik të vërtetë.

Popullsia e Poliçanit ka pasur një luhatje ndër vite. Në vitin 1985 numri i popullsisë ishte rreth 6500 banorë, duke pësuar një rritje progresive në vitin 1989 me rreth 11 000 banorë. Pas vitit 1990 për shkak të emigracionit, lëvizjes së lirë, kërkimit të një jete dhe ekonomie më të mirë, popullsia pësoi një ulje për të arritur në vitin 2001 në 10 471 banorë.




Lëvizjet e banorëve nga qyteti i vogël i Poliçanit drejt qendrave të mëdha të banimit, kanë sjellë një rënie drastike të popullsisë duke regjistruar në vitin 2009 rreth 10 000 banorë.

Aktualisht numri i popullsisë së Poliçanit është 8372 banorë dhe 2792 familje. Numri i lindjeve në qytetin e Poliçanit është 70 lindje/vit dhe numri i vdekjeve 35 vdekje/vit.

Popullsia e Bashkisë Poliçan përbën rreth 4.7 % të popullsisë totale në qarkun e Beratit. Sipas të dhënave trendi i rritjes së popullsisë së qytetit të Poliçanit, në periudhën 2004-2011 ka qene 2% ndërkohë që popullsia në Shqipëri dhe në qarkun e Beratit ka pasur rënie sipas censusit të vitit 2011, 16-25% në nivel qarku dhe 8 % në nivel kombëtar. Rritja e popullsisë të këtij qyteti ka ardhur duke u rritur gjatë dekadës së fundit për shkak të migrimit të njerëzve nga fshatrat përreth. Gjithashtu vihet re dhe një tendencë tjetër që kanë banorët e qytetit të Poliçanit për tu larguar në zonat urbane më të mëdha.

Popullsia e Bashkisë Poliçan do të ndryshojë për shkak të ndarjes së re territoriale (Ligji nr. 115/2014, datë 31.7.2014 “Për ndarjen administrativo - territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”) duke ju bashkangjitur njësia vendore Vërtop me fshatrat (Mbrakull, Vërtop, Kapinovë, Zgërbonjë, Vodicë, Fushë Peshtan, Peshtan, Drenovë, Lybeshë, Tomor i madh, Tomor i vogël, Bregas), dhe njësia vendore Tërpan me fshatra (Tërpan, Teman, Paraspuar, Tozhar, Vokopolë, Dodovec, Rehovë, Zhapokikë, Çorogjaf, Panarit, Plashnik i Madh, Lugas, Zhitom i Madh, Zhitom i Vogël).



6.1 Zona e Projektit


Ky projekt shtrihet në qytetin e Policanit, përkatesisht në lagjet: Lagjia Qendër dhe Lagjia Poligoni. Gjendja ekzistuese e këtyre zonave paraqitet si në fotot që vijojnë:

RRUGA PËR PALLATEVE POLIGON






RRUGA "RILINDJA"



AMBJENTI I PENSIONISTEVE



PARKIMI



7 PREZANTIM DHE TE DHENA

7.1 Qëllimi i Studimit dhe Projektimit

Qëllimi i bërjes së materialeve është të realizojë projektin e detajuar teknik të lagjeve, rrugëve dhe objekteve të qytetit të Policanit.

8 OBJEKTIVAT

8.1 Qëllimi dhe rezultatet e pritshme

Qëllimi : Rehabilitimin e infrastrukturës urbane dhe përmirësimin e jetesës së banorëve.

Qëllimi specifik i është mirëmbajtja e rrugëve, shesheve dhe objekteve

8.2 Qëllimet e veçanta të Projektit

Qëllimi primar I këtij projekti është zbatimi i projektit të detajuar për rikonstruksionin e rrugëve, shesheve dhe objekteve publike në qytetin Polican (se bashku me strukturat e nevojshme që mund të vendosen në këto gjurme, egzistuese apo të re) si dhe arrenxhimi i investigimeve të nevojshme për të grumbulluar të dhëna të mjaftueshme për të arritur qëllimin e mesipër, projektin e detajuar studimet e nevojshme gjeologjike, hidraulike, topografike.



9 MBLEDHJE TE DHENASH, HARTIME DHE PROJEKTE RRUGE

9.1 Grumbullim të dhënash dhe inspektim terreni

Gjate fazes se pare por edhe në fillim të projektit te zbatimit ekspertët tane filluan të familiarizohen me realitetin e zonës së projektit duke realizuar nje sere vizitash ne kantier, duke kryer kqyrjen ne vend te gjate gjithë gjurmes se re te aprovuar.

Janë ndërmarrë aktivitetet që vijojnë, esenciale këto për përpunimin e vizatimeve

- ▶ pasuese: Mbledhja e dokumenteve të disponueshme, harta dhe të dhëna.
- ▶ Rilevimi topografik i zonës se gjurmes për të mbledhur informacion teknik për situatën aktuale.
- ▶ Survejimi trafikut

Investigimi në terren i bërë nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit kanë siguruar informacion të rëndësishëm për vlerësimin e situatës aktuale me qellim realizimin e nje projekti sa me te sakte te pershtatshm me terrenin dhe sa me te kuptueshem

Surveime Topografike per fazen e project idese

Në projektin per Rikonstruksione rrugëve, lagjeve te qytetit te Policanit dhe objekteve publike eshte aplikuar teknologjia me e fundit e prodhimit te DTM, janë përdorur kartografi nga fotografite digitale. Keto kanë ndihmuar në sigurimin e të dhënave cilësore e sasiore të dhe ato janë zgjedhur si referenca për vizatimet që janë prezantuar (nga të cilat më të rëndësishmet janë ato që i referohen përcaktimit gjeometrik). Projekti është realizuar duke përdorur hartat e perfituara nga Orthofotot (me izoipse në 3D), me shkallë 1:10,000. Me pas, me miratimin e Variantit eshte vazhduar me hartimin e relievit topografik me metoden klasike, matje ne terren me total station.



Puna gjeodezike dhe topografike për Projekt-Preventivi i zbatimit te rikonstruksionit te sheshit ne qendren e fshatit Veliqot u bazua ne kërkesat teknike të përgjithshme, të kërkesave specifike të parashtruara nga termat e references te renditura ne kontraten e investitorit me firmën projektuese, si dhe mbi bazën e përvojës së përftuar në punimet e meparshme të kësaj natyre.

Njohja fillestare me detyren topografike motivoje grupin e punes ne pergatitjen e materialeve gjeodezike e cila fillon me sigurimin e hartave dhe të koordinatave të pikave mbështetëse gjeodezike për zonën ku shtrihet rruga. E cila shërbeu për përcaktimin e saktë të metodikës dhe organizimit të punës dhe për mënyrën e ndërtimit të rrjetit gjeodezik mbeshtetes. Me pas ne terren se bashku me prujktuesit , grupi topografik mori udhezimet per gjurmen e aksit permiresimi i parametrave te planimetrise se rruges duke patur parasysh kategorie e saj . Si dhe identifikimi i veprave te artit , azhornimi i tyre si nga ana funksionale dhe pershtatja pozicionale sipas aksit te ri. Korigjimi i pjerresive duke patur parasysh permiresimin altimetrik ne sinkron me pozicionin planimetrik te rruges ekzistuese me variantin e

projektuesit. Grupet ne terren do te perbehen nga nje Inxhiner ekspert Topograf , nje teknik i mesem topograf me eksperience ne procesin e rilevimit dhe 2 punetor.

Pas grumbullimit te dokumentacionit te nevojshem teknik dhe ligjor grupet e punes ne terren filluan menjehere nga puna duke bere rikonjucionin e rruges. Duke u konsultuar me termat e references

Pas rikonjucionit te zones filloj materializimi i pikave mbeshtetese gjeodezike i cili do te sherbeje per rilevimin dhe azhornimin e gjithe zones.

Metoda per ndertimin e ketij rrjeti gjeodezik do te bazohet mbi teknologjine e fundit te shkences dhe te elektronikës ne fushen e gjeodezise. Per kete proces do te perdoret GPS Trimble 5800 me nje precision teper te larte ne matje.

Ne distance $0.001 \text{ m} + 1 \text{ ppm}$

Matje vertikale $0.01 \text{ m} + 2$

ppm Nje precision i tille do na garantoje arrijten e nje saktësie

brenda normave te kerkuara.

Per rilevimin dhe azhornimin e zones çdo grup do te jete i pajisur me instrument te nje precisioni te larte Total Station (Trimble 5603

DR200+) Ne distance $\pm 3 \text{ mm} + 3 \text{ ppm}$

Ne kend $0.01 \text{ mgon} = 0.1 \text{ cc}(1'')$

Perdorimi i instrumentave ne fjale ben te mundur kalimin e informacionit te marre ne terren direkt ne kompjuter dhe krijimin pa veshtiresi dhe teper te sakte te hartave treguese.

Rilevimi i zones

Duke u mbështetur në pikat e poligonometrisë u zhvillua rrjeti i rilevimit të zonës prane para pallateve ne lagjen Poligon.. Rilevimi u krye kryesisht mbi bazë të profilit gjatësor dhe të profilave tërthorë, por duke marrë dhe pika detaje plotësuese midis tyre për të krijuar modelimin e saktë të relievit përgjatë gjithë brezit. Në përcaktimin e profilave tërthorë jemi bazuar kryesisht në kushtet e terrenit dhe në përputhje me kërkesat e përgjithshme teknike të hartimit të projektit. Gjerësia e rilevimit ka qene variabel deri 50 metra, por në raste të veçanta ka arritur dhe më shumë metra. Janë kryer matje plotësuese e më të zgjeruara në të gjitha vëndet ku mendonim se do të jete nevojshme se ndihet ndikimi i rreshqitjes.



Janë marrë gjithashtu dhe linja e tensionit që kalojnë në brezin e parashikuar të rilevimit, ose që kryqëzohen me atë. Është treguar kujdes i veçantë për rilevimin sa më të saktë të relievit dhe të formave të tij, sepse në shpatet me pjerësi të madhe saktësia e modelimit të relievit ndikon ndjeshëm në llogaritjen e volumeve.

Saktësia e GCP është percaktuar brenda kontureve të percaktuara me parë nga topocentric me saktësi $\pm 3\text{cm}$ në plan e lartësi, Konturi ku janë matur pikat kanë qenë objekte që identifikohen saktë nga fotografia ajrore

Llogaritjet

Te gjitha bazat janë procesuar duke përdorur softëare profesional Statik-Kinematik Magnet (GPS Topcon Hiper II), duke përdorur pikat nderkombetare; Graz, Mate, Autila, Ohrid, Penc dhe Sofie, për percaktimin e koordinatave të bazave. Matjet e këtyre pikave nderkombetare janë shkarkuar nga interneti. Për zgjidhjen e bazave janë eliminuar observimet nën 15 shkallë me horizontin e instrumentit për të eliminuar gabimet e multipathit, dhe g.m.k. I lejuar për zgjidhjen e bazave maksimal është vendosur $\pm 2\text{cm}$.



Sistemi i referimit

Sistemi i referimit është sistemi i njohur gjerësisht në përdorimin e GPS, me ellipsoid EGS84 dhe me projeksion UTM34, gjithashtu për llogaritjen e lartësive ortometrike është përdorur modeli I GEOID"-it, EGM96.

Ketu po bëjmë një historik të Rrjetit koordinativ Shtetëror:


Dihet se rrjeti gjeodezik shtetëror aktual i Shqipërisë u ndërtua në periudhën 1970 – 1985 nga Instituti Topografik i Ushtrisë – ITU (sot Instituti Gjeografik Ushtarak i Shqipërisë – IGUS). Ky rrjet gjeodezik kryesor përbëhet nga triangulacioni dhe nivelimi shtetëror

PERSHKRIM PROJEKTI



A. Lagjia qendër, rruga “Rilindja”.

Per Rikonstruksion i rrugëve, “Rilindja” Bashkinë Polican, jemi fokusuar ne perdorimin e materialeve qe gjenden ne vend, duke ruajtur ne kete menyre nje ekuiliber me mjedisin qe e rrethon, duke krijuar njekoheesisht nje rrugë që i reziston kohës në unison me rrugët e tjera lidhesëe. Rruga “Rilindja “ në lagjen qendër do te realizohet në një siperfaqe: 1190 m²,

Ne keto sipërfaqe ujerat e shiut do te orientohen drejt kusetave dhe me pas derdhen ne pusetat ekzistuese.



Materiali qe do te perdoret për shtrimin e rrugës “Rilindja” do te jete guri i bardhe dhe gri ne forme pllaka guri, me dimensione 20 x variable x 4 dhe fugature 1.5cm ndermjet tyre. Shtresat qe vijojne poshte gurit jane: shtrese llaci, shtrese betony 10 cm dhe shtrese zhavorri 15cm.




B. Lagjia "Poligon".

Per rikonstruksionin urban te sheshit para pallateve ne lagjen "Poligon", jemi fokusuar ne perdorimin e materialeve qe gjenden ne vend, duke ruajtur ne kete menyre nje ekuilibër me mjedisin qe e rrethon, duke krijuar njekohesisht nje shesh mjaft elegant.



Materiali qe do te perdoret me shtrimin e sheshit do te jete pllaka betoni, qe do të dalin nga rikonstruksioni i parkimit pas bashkisë me fugature 1.5cm ndermjet tyre. Shtresat qe vijojne poshte gurit jane: shtrese rëre, shtrese betoni dhe shtrese zhavorri. Njekohesisht do të vendosen bordura betoni për kufizimin e hapësirave midis mjeteve dhe këmbësorëve

Sipërfaqja që do të shtrohet është rreth 470 m²




Para pallateve në poligon do të realizohet një rrugë me sipërfaqe: 470 m², dhe bordura do të jetë po me gure.

Gjithashtu, është menduar krijimi i disa hapësirave të gjelbërta të mbjella me bar me peme dhe lule dekorative. Në disa vende të caktuara janë pozicionuar stola.




Ndricimi do të jetë i përqendruar në të gjithë gjatësinë e sheshit, do të jetë ndriçues i kompletuar. Në këto sipërfaqe do të Ujerat e shiut do të orientohen drejt kuletave dhe me pas derdhen në kanalin ekzistues. Do të mbillen peme dekorativ

Detaje mbi ndriçuesit që do të përdoren në objekte

Hollësi e vendosjes së pusëtës




Hollësi e inkastrimit të kolonës së ndriçuesit




C. "Parkimi i bashkisë".

Per rikualifikimin urban te sheshit të parkimit të bashkisë", jemi fokusuar ne perdorimin e materialeve qe gjenden ne vend, duke ruajtur ne kete menyre nje ekuiliber me mjedisin qe e rrethon, duke krijuar njekoheesisht nje shesh mjaft funksional dhe elegant, si dhe rehabilitimi i kullimit të ujrave sipërfaqësorë dhe kanalizimit të ujrave të ndotura në lulishten pas bashkisë dhe në hyrje të pallatit



Materiali qe do te perdoret me shtrimin e sheshit do te jete guri i bardhe dhe gri ne forme pllaka guri, me dimensione 20 x variable x 4 dhe fugature 1.5cm ndermjet tyre. Shtresat qe vijojne poshte gurit jane: shtrese llaci, shtrese betony 10cm dhe shtrese zhavorri 15cm.





SPECIFIKIMET TEKNIKE TË PRODUKTIT -

Barrierat Deri në 4 m të gjatë

Furnizimi me linja elektrike 230V AC - 50 Hz

Furnizimi me energji motorike 36V DC -

Thithja elektrike 0-15A -

Vlerësimi i fuqisë 220 Ë -

Frekuenca e përdorimit Vazhdoni përdorimin

Çift rrotullues 0 - 200 N m -

Temperatura e funksionimit - 20 + 55 C°

Niveli i mbrojtjes IP54

Lloji i reduktuesit i pakthyeshem

Koha e hapjes në 90° 2÷6 sek (deri në 3 m) - 3÷6 sek (deri në 4 m)

Njësia e kontrollit në bord CTRL Kontrolluesi dixhital 36V DC -

Enkoder Enkoder dixhital amtare + magnetik dixhital SENSORED, 4096 PPR -

Furnizimi me energji shtesë 24V DC -

Sistemi i lëshimit Cilindri i çelësit STANDARD - Cilindri evropian opsional (kod. RL670)

Rikuperimi i baterive i disponueshem

Sinkronizimi BUS Master/Slave Po

Ciklet e funksionimit në ditë (hapje/mbyllje - 24 orë pa ndalim) 5000 cikle

Gjithashtu, është menduar krijimi i disa hapësirave të gjelbërta të mbjella me bar me pemë dhe lule dekorative. Në disa vende të caktuara janë pozicionuar stola.


Ndricimi do të jetë i përqendruar pranë stolave dhe do të realizohet me ndihmën e shtyllave elektrike. Në këto sipërfaqe do të vendosen edhe kosha për hedhjen e mbeturinave. Ujërat e shiut do të orientohen drejt kuletave dhe me pas derdhen në pusetat ekzistuese.

Objekti; Ambjenti i pensionistëve

Për rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e ambjentit shlodhës dhe argëtues të pensionistëve jemi fokusuar

tek krijimi i një ambjenti sa më komod, shlodhës, argëtues për moshat e treta me qëllim që të kënaqet një ambjent të tyrin, të konsumojnë dhe një kafë të ofruar nga ana e bashkisë. Një ambjent të ngrohtë, të mbrojtur nga temperaturat e ftohta dhe të nxehta, të pajisur me tavolina dhe karrige



ku të kenë mundësinë të zhvillojnë dhe një lojë letra, domino apo diçka tjetër. Punimet që do të kryhen në këtë ambient do të jenë stukime, lysterje, vendosje dyer, dritare d/alumin dhe shtrim me pllaka.




Objekti; “Banjo publike”

Në qytet mungojnë banjot publike që nga vitet 1995. Në bazë të kërkesave dhe nevojave të qytetarëve por jo vetëm, është hartuar projekti nga ana e Drejtorisë së Planifikimit të Territorit për ndërtimin e banjove publike në qytet.

Banjot do të ndërtohen tek terminali në atë pozicion që kanë qenë banjot e vjetra. Objekti do të ndërtohet dhe do të menaxhohet nga bashkia, do të jenë në funksion të plotë të qytetarëve dhe udhëtarëve.



Do të jenë 2 EC për burra dhe 2 EC për Gra me hyrje të veçanta



(Sip. ndertimit 13.7 m²)

1- Barriera automatike per parkim

Barrierat Deri në 4 m të gjatë

Furnizimi me linja elektrike 230V AC - 50 Hz

Furnizimi me energji motorike 36V DC -

Thithja elektrike 0-15A -

Vlerësimi i fuqisë 220 W -

Frekuenca e përdorimit Vazhdoni përdorimin

Çift rrotullues 0 - 200 N m -

Temperatura e funksionimit - 20 + 55 C°

Niveli i mbrojtjes IP54

Lloji i reduktuesit i pakthyeshem

Koha e hapjes në 90° 2÷6 sek (deri në 3 m) - 3÷6 sek (deri në 4 m)

Njësia e kontrollit në bord CTRL Kontrolluesi dixhital 36V DC -

Enkoder Enkoder dixhital amtare + magnetik dixhital SENSORED, 4096 PPR -

Furnizimi me energji shitesë 24V DC -

Sistemi i lëshimit Cilindri i çelësit STANDARD - Cilindri evropian opsional (kod. RL670)

Rikuperimi i baterive i disponueshem

Sinkronizimi BUS Master/Slave Po

Ciklet e funksionimit në ditë (hapje/mbyllje - 24 orë pa ndalim) 5000 cikle

2- Fasade xhami, xham i tempouar me trashesi 8 mm me permasa 500 * 300 cm me porte teke ne qender, me mentesha metalike

3- Pllake majolike, me permasa 120x60 cm pa shkelqim

4- Pllake majolike, me permasa 30x30 cm pa shkelqim

5- Cimento

- Paketimi: 25kg/thes
- Përdorimi: Per llac
- Tipi: 32.5 R

6- Stuko pllakash

Stuko pllakash, me bazë çimentoje, e modifikuar me polimerë, me mpiksje të shpejtë. Ofron rezistencë të lartë mekanike, qëndrueshmëri të shkëlqyer të ngjyrës dhe aftësi të lartë ujëlarguese. Ofron një sipërfaqe përfundimtare të lëmuar dhe me shkëlqim. E përshtatshme për gjerësi fuge deri në 8 mm. Përdoret për stukimin e pllakave të çdo lloji, në mure, dysheme, mjedise të brendshme dhe të jashtme.

7- Fino suvatimi

- Konsumi: 2-2.3 kg/m²
- Paketimi: 25 kg
- Forma: Pluhur
- Përdorimi: I përshtatshëm për realizimin e rifiniturave të sipërfaqeve të mbushura me llaç tradicional ose me l
- Raporti i përzierjes: 7.5-8litra ujë për 25 kg Fino të bardhë /gri
- Temperatura: +5°C deri në +35°C

FINO CLASSIC është material në formë pluhuri i prodhuar në bazë të teknologjisë HTT (Hörman Transpirance Tecnology) që parandalon krijimin e mykut dhe lejon transpirimin e murit me bazë çimento, gëlqere e hidratuar, rërë guri karbonik dhe mermer me granulometri të seleksionuar, rezina sintetike dhe adetive speciale. Karakterizohet nga hapje dhe punueshmëri mjaft e mirë, mbulueshmeri shumë e lartë (10-12m² / thes 25 kg). Lehtëson aplikimin në sipërfaqe të jashtme edhe të brendshme të mbushura si me llaç tradicional ashtu dhe me llaç të parapërgatitur. E aplikueshme deri në një trashësi deri në 3 mm. E përshtatshme për realizimin e rifiniturave të sipërfaqeve të mbushura me llaç tradicional ose me llaç të parapërgatitur me bazë çimento-gëlqere. Mund të mbulohet me bojë ose me veshje të tjera me natyrë minerale dhe sintetike.

8-Lule Vjola

Bimë barishtore shumëvjeçare, 5-15cm, me rozetë gjethesh dhe me stolone. Gjethet rrotullore, me bazë si zemër. Lulet ngjyrë vjollcë ose të bardha, aromatike. Petlat anësore të drejtuara nga poshtë, kurora jo e rregullt, me shpor më të gjatë se shtojcat e kupës.

9-Dritare dhe dyer

Dritaret/informacion i përgjithshëm/kërkesat Dritaret janë pjesë e rëndësishme arkitektonike dhe funksionale e ndërtesës. Ato sigurojnë ndriçimin për pjesët e sipërfaqes së brendshme të tyre. Madhësia (kupto dimensionet) e tyre variojnë, varet nga kompozimi arkitektonik, nga madhësia e sipërfaqes së brendshme dhe kërkesat e tjera të projektuesit. Dritaret duhet të jenë në kuotë 80-90 cm mbi nivelin e dyshemesë, kjo varet dhe nga kërkesat e projektuesit. Dritaret mund të jenë të prodhuara me dru, alumin ose PVC. Pjesët kryesore të dritareve janë: Kasa e dritares që fiksohet në mur me elemente prej hekuri përpara suvatimit. Korniza e dritares do të vidhoset me kasën e saj mbas suvatimit dhe bojatisjes. Në bazë të vizatimit të dritares së treguar në vizatimin teknik, korniza do të pajiset në kasë me mentesha dhe bllokues të tipeve të ndryshme të instaluar në të. Kanate me xhama të hapshëm, të pajisur me mentesha, doreza të fiksuara dhe me ngjitës transparent silikon, si dhe me kanata fikse.


Dritarja e kornizës e lehtë për t'u montuar dhe përdorur, me hermetik të mirë, të izolojë zhurmën

dhe të izolojë mirë zhytjen e ujit të shiut. Dritarja e kafazit mund të hapë plotësisht dritaren për ajrim të mirë, dhe është e lehtë për t'u pastruar në përdorim të përditshëm.

Xham I dyfishtë I perbere nga dy panele qelqi perms nje ndaresi alumin termik, te ofroj izolim trmiko-akustik.

Veshje elektropluese, sipërfaqja është e lëmuar dhe pa gërvishtje

Furnizimi dhe vendosja e dritareve siç përshkruhet në specifikimet teknike me dimensione të dhëna nga kontraktori, përbëhen nga material PVC profilet e të cilit janë sipas standarteve Europiane ISO EN 9002






Ngjyra e dritares do të jetë sipas kërkesës së investitorit. Dritaret rrëshqitëse të PVC duhet të sigurojnë izolim meanë të një gome dhe adaptues në lidhje me kornizën. Seleksionimi I hapësirave të ndryshme lejon përdorim xhami tek ose dopio. Boshllëku brenda xhamit dopio duhet të jetë 20-24mm. Sistemet e dritareve PVC duhet të sigurojnë në mënyrë perfekte izolimin nga ajri dhe uji. Ato duhet të sigurojnë një rezistence nga uji nën 500Pa (të barazvlefshme me shpejtësinë e erës prej 150km/orë). Testet për këtë duhet të jenë në përputhje me DIN 18055. Koefficienti I konduktivitetit termal duhet të jetë 2.0W (m2K) e cila konfirmon Standartet Europiane. Në lidhje me izolimin e zërit, dritaret prej PVC duhet të sigurojnë izolim ndaj tingujve deri në shkallën 4 (>40dB). Korniza fikse e dritares (ndarjet) do të ketë një dimension 74-116mm. Ato janë të siguruar me elemente, që shërbejnë për vendosjen dhe ankorimin në strukturat e murit si dhe pjesët e dala që shërbejnë për rrëshqitjen e skeletit të dritares. Forma e profilit është tubolare me qëllim që të mbledhë gjithë aksesorët e saj. Profili i skeletit të dritares do të jetë me përmasën 25 mm e cila do të mbulohet nga profili kryesor qe do të fiksohet në mur. Të dyja korniza fikse ose të lëvizshme janë projektuar dhe janë ndërtuar me fugë ajri që shërben si thyerje termike. Ato duhet të ofrojnë zbatim të Standarteve Europiane të vendosjes së xhamit (Xham tek 4-6mm, xham dopio 20-24mm, xham tresh 24-28 mm), me kullues uji me mbledhës uji, me inklinim 2 gradë për të siguruar ~~kullim uji perfekt, mbyllje perfekte nga mbyllësit qëndror, trashësi muri që arrin EN (të~~ 3.1mm), izolim për erën dhe shiun ulluk unik I projektuar për të ndihmuar instalimin e materialeve të gomuar, që shërbejnë për këtë qëllim. Karakteristikat e ngjitësit kundër agjentëve atmosferike duhet të jenë të provuar nga një testim i çertifikuar i bërë, nga prodhuesit e kornizës së dritares ose nga prodhuesit e profileve

Shtylle e ndricimit rrugore te ngjitur me ngritje me shkalle me gjatesi 7.8m



article	L mm	l mm	s mm	D mm	d mm	m ²	door article	weight kg	qty pack
4303	3.000	500	3	76	60	0,66	4300/LDT	15,50	1
4353	3.500	500	3	76	60	0,76	4300/LDT	18,13	1
4403	4.000	500	3	76	60	0,88	4300/LDT	20,50	1
4453	4.500	500	3	76	60	0,96	4300/LDT	23,50	1
4503	5.000	500	3	89	60	1,20	4300/LDT	29,00	1
4553	5.500	500	3	102	60	1,45	4300/LDT	36,00	1
4603	6.000	500	3	102	60	1,67	4300/LDT	38,50	1
4703	6.800	800	3	127	60	2,29	4301/LDT	57,50	1
4703/139	6.800	800	3	139	60	2,42	4301/LDT	62,00	1
4703/4	6.800	800	4	127	60	2,29	4301/LDT	67,00	1
4703/4-152	6.800	800	4	152	60	2,69	4301/LDT	82,00	1
4703/4-168	6.800	800	4	168	60	2,94	4301/LDT	89,00	1
4704	6.800	800	3	114	60	1,86	4301/LDT	55,00	1
4803	7.800	800	3	127	60	2,63	4301/LDT	64,00	1
4803/4	7.800	800	4	127	60	2,60	4301/LDT	74,00	1
4803/4-152	7.800	800	4	152	60	3,06	4301/LDT	90,00	1
4803/4-168	7.800	800	4	168	60	3,29	4301/LDT	99,00	1
4803/4-193	7.800	800	4	193	60	3,72	4301/3	112,00	1
4903	8.800	800	3	127	60	2,95	4301/LDT	70,00	1
4903/139	8.800	800	3	139	60	3,06	4301/LDT	75,00	1
4903/4	8.800	800	4	127	60	2,95	4301/LDT	80,00	1
4903/4-152	8.800	800	4	152	60	3,39	4301/LDT	97,00	1
4903/4-168	8.800	800	4	168	60	3,71	4301/LDT	106,00	1
4903/4-193	8.800	800	4	193	60	4,26	4301/3	141,00	1
4903/5-219	8.800	800	5	219	60	4,59	4301/3	154,00	1
4103	9.800	800	3	139	60	3,46	4301/LDT	83,00	1
4103/4	9.800	800	4	139	60	3,46	4301/LDT	94,00	1
4103/4-152	9.800	800	4	152	60	3,85	4301/LDT	116,00	1
4103/4-168	9.800	800	4	168	60	4,00	4301/LDT	126,50	1
4103/4-193	9.800	800	4	193	60	4,78	4301/3	141,00	1
4103/5-219	9.800	800	5	219	60	5,20	4301/3	187,00	1
41103	10.800	800	3	139	60	3,65	4301/LDT	90,00	1
41103/4	10.800	800	4	139	60	3,65	4301/LDT	100,00	1
41103/4-152	10.800	800	4	152	60	3,94	4301/LDT	114,00	1
41103/4-168	10.800	800	4	168	60	4,10	4301/LDT	125,00	1
41103/4-193	10.800	800	4	193	60	5,30	4301/3	158,00	1
41103/5-219	10.800	800	5	219	60	5,36	4301/3	196,00	1
41203/4	11.800	800	4	152	60	4,35	4301/LDT	120,00	1
41203/4-168	11.800	800	4	168	60	4,65	4301/LDT	132,00	1
41203/4-193	11.800	800	4	193	60	5,75	4301/3	169,00	1

Maximum diameter 219 mm



ND-100-100

Light source - Tipologia sorgente - Burimi i drites:

LED

Protection - Protezione - Mbrojtja:

IP66 IK09

Beamangle-Angolo diapertura - Kendi :

155°

Color temperature - Temperatura di colore - Temperatura e ngjyres:

4000K

Nominal lumen - lumen nominali - Lumen:



17500lm

CRI- IRC - CRI:

>70

Operating temperature - Temperatura di esercizio - Temperatura e punes:

-25°C/+50°C



Lifespan: 100.000 hr
Jetegjatesia: 100.000 ore



PREVENTIVI

1- LLOGARITJA E KOSTOS

Lista e cmimeve

Cmimet njësi janë nxjerrë në bazë të punimeve ndërtimore të kohëve të fundit për punë të ngjashme për secilën nga alternativat e studiuara. Kostoja totale e investimit është bërë nga zërat sipas preventivin vijonë:

Për disa zera punimesh, që për fazën project-idese janë te lejueshme, janë përdorur cmime njësi për zë pune, ndërkohë kategoritë e tjera si (tombino rrethore, tombino kuti, ura, mure mbajtëse, drenazhime) janë përdorur kosto njësi parametrike, në bazë të kostove të ndërtimit vendas në Shqipëri. Kështu kostoja e zërave të punës me sasi të përcaktuar është llogaritur duke aplikuar cmime njësi aktuale të marra nga Manual i Preventivimit 2015 i miratuar me VKM

Por, duhet të themi që:

Eshtë thelbësore që punimet për rehabilitimin e strukturave duhet të kryhen sipas rregullave të zbatimit teknik në fuqi në përputhje me specifikimet teknike të projektit.

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT, BUJQËSISË DHE VETERINARISË

Ing. Ferdinand Avdiaj



Tek. Lulieta Tare



Stol per lulishte konstrukt metalik dhe mbeshtetese me dru natyral me permasa 160x50x68cm.

